



REPUBLIKA E KOSOVËS /
REPUBLIKA KOSOVA / KOSOVA CUMHURIYETI

C.nr.945/09

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, gjyqtari Arsim Hamzaj, me sekretaren juridike Majlinda Shala, në kontestin e paditësit B. Rr. nga fshati K., Komuna e Prizrenit, të cilin me autorizim e përfaqëson av. S. K. nga Prizreni, kundër të paditurit A. Sh. nga Prizreni, të cilin me autorizim e përfaqëson av. R. B. nga Prizreni, për shkak të kompenzimit të dëmit, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor, me datën 19.06.2014, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET pjesërisht kërkesëpadia e paditësit B. Rr. nga fshati K., Komuna e Prizrenit, dhe **obligohet** i padituri A. Sh. nga Prizreni, që në emër të dëmit t'ia kompenzojë paditësit shumat si në vijim:

- për dhimbje fizike (trupore), shumën prej 1,500.00 euro;
- për dhimbje shpirtërore për shkak të shëmtimit, shumën prej 300.00 euro, respektivisht shumën e përgjithshme prej **1,800.00 euro**, me kamatë ligjore 3.5%, duke e llogaritur atë nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi (19.06.2014), e deri te pagesa definitive.

II. Obligohet i padituri që shumën nga pika **I** e dispozitivit si dhe shpenzimet procedurale në lartësi prej **285.20 euro**, t'ia paguajë paditësit në afat prej 15 ditësh pas ditës së pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcnim të përmbarimit me dhunë.

III. Pjesa tjetër e kërkesëpadiës së paditësit B. Rr., mbi shumat e aprovuara sikurse në dispozitivin nën **I** të këtij aktgjykimi, e deri në shumën e kërkuar prej **15,000.00 euro**, **refuzohet si e pa bazuar**.

A r s y e t i m

Paditësi B. Rr., përmes të autorizuarit të tij pranë kësaj gjykate ka parashtruar padinë për kompensimin e dëmit jo material, kundër të paditurit A. Sh. nga Prizreni, duke theksuar se pas një mosmarrëveshje me të paditurin i njëjti ka pësuar lëndime fizike dhe tronditje psikike. Si rezultat i kësaj i padituri është shpallur fajtor dhe i njëjti aktgjykim është vërtetuar edhe nga Gjykata Supreme e Kosovës me aktgjykimin P.nr.223/2009, të datës 15.10.2009. Andaj në bazë të lartcekurave ka kërkuar nga gjykata që ta detyrojë të paditurin që në emër të kompenzimit të dëmit t'ia paguajë paditësit shumën prej 5,000.00

eurove për dhimbjet fizike dhe 10,000.00 për gjurmët e ngelura- shëmtimin, në përgjithësi shumën prej 15,000.00 eurove.

Edhe përgjatë shqyrtimit gjyqësor, i autorizuari i paditësit av. S. K. nga Prizreni, kryesisht ka ngelur pranë padisë, ndërsa në fjalën e fundit duke u bazuar në ekspertizën e ekspertit mjekësor Dr. Xh. S., ortoped-traumatologu dhe provave tjera të administruara ka propozuar gjykatës aprovimin e kërkesëpadisë në tërësi si të bazuar. Gjithashtu, në emër të shpenzimeve të procedurës i ka kërkuar shumën në lartësi prej 690 euro dhe atë për katër seanca nga 135 euro si dhe për ekspertizë shumën prej 150 euro.

Përmes përgjegjës me shkrim në padi, i padituri, ka deklaruar se e konteston padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit, duke theksuar se nga aktgjykimin i plotfuqishëm penal rrjedhë se paditësi ka pësuar lëndime të lehta trupore dhe nuk mund të jetë bazë për dëmshpërblim, sepse dhimbjet fizike nga lëndimi i lehtë trupor nuk janë të intenzitetit të tillë për të arsyetuar dëmshpërblimin. Po ashtu ka deklaruar se edhe kërkesa për dëmshpërblim për shkak të shëmtimit është e pa bazë, pasi që shëmtimi nuk ka qenë i shkallës së tillë në mënyrë që të tjerët të shikojnë me përbuzje ose me keqardhje për personin të cilit i është shkaktuar. Andaj në bazë të këtyre arsyeve ka propozuar refuzimin e kërkesëpadisë si të pa bazuar.

Edhe gjatë shqyrtimit gjyqësor, i autorizuari i të paditurit av. R. B. ka deklaruar se mbetet pranë përgjigjes me shkrim të dhënë ndaj padisë, ndërsa në fjalën e fundit ka theksuar se nga provat e administruara është vërtetuar se i padituri është shpallur fajtor me aktgjykimin penal për veprën penale lëndimi i lehtë trupor. Në kontestin për dëmshpërblim gjykata është e lidhur me aktgjykimin penal për të cilin shkaktuesi i dëmit është shpallur fajtor. Nga kjo rrjedhë se paditësi ka pësuar lëndime të lehta trupore që sipas ligjit nuk ka të drejtë në dëmshpërblim përpos në raste të veqanta. Andaj në bazë të të lartcekurave i ka propozuar gjykatës që kërkesëpadinë e paditësit ta refuzojë si të pa bazuar. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar në shumë prej 405 euro, në emër të tri seancave të mbajtura.

Për vërtetimin e drejtë të gjendjes faktike gjykata ka administruar provat si në vijim: Aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Prizren P.nr.156/08, të datës 05.02.2009; Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, Ap.nr.223/09, të datës 15.10.2009; Kartelën evidentuese të lëshuar nga Qendra Regjionale për punësim, me datë 10.02.2010; Çertifikatën e lëshuar nga Qendra Regjionale për punë dhe punësim e datës 20.11.2009; Mendimin e ekspertit mjeko-ligjor dr. C. M., të datës 15.01.2009; Raportin e radiologut të lëshuar nga Spitali Regjional në Prizren, datë 08.07.2008 si dhe është marrë mendimi i ekspertit mjekësor dr. Xh. S., ortoped – traumatolog.

Gjykata pas vlerësimit të pohimeve të palëve ndërgjyqëse dhe provave të lartcekura, në kuptim të nenit 8 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha ato së bashku dhe ka gjetur se:

Kërkesëpadia e paditësit është **pjesërisht e bazuar.**

Në bazë të aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prizren P.nr.156/2008, të datës 05.02.2009, gjykata ka vërtetuar faktin se këtu i padituri A. Sh., është shpallur fajtor dhe është dënuar me dënim me gjobë për veprën penale armëmbajtje pa leje dhe shkaktimi i lëndimit të lehtë trupor.

Në bazë të Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, Ap.nr.223/09, të datës 15.10.2009, Gjykata ka vërtetuar faktin se është vërtetuar aktgjykimi i gjykatës së qarkut në Prizren, P.nr.156/2008, të datës 05.02.2009, me të cilin i padituri A. Sh., është shpallur fajtor dhe është dënuar me dënim me gjobë për veprën penale armëmbajtje pa leje dhe shkaktimi i lëndimit të lehtë trupor, vetëm është ndryshuar pjesërisht përkitazi me cilësimin juridik të veprës.

Në bazë të ekspertizës së ekspertit mjekësor Dr. Xh. S., ortoped-traumatolog, gjykata ka konsideruar si të provuar faktin se i njejtë ekspert pas vlerësimit të të gjithë dokumentacionit i cili gjindet në shkresat e lëndës dhe pas ekzaminimit të drejtëpërdrejtë që i ka bërë paditësi ka konstatuar se paditësi në rastin e lëndimit ka pësuar plagë nga ana e zjarrit, në regjionin e anës së majtë të mjekrës, ku aktualisht ende ekziston trupi i huaj metalik, dhe për këtë lëndimi karakterizohet si lëndim të rëndë trupor por pa pasojë funksionale për organizmin.

Në mes të palëve ndërgjyqëse gjatë shqyrtimit kryesor nuk ka qenë kontestues fakti se paditësi në ditën kritike është qëlluar nga ana e të paditurit me armë dhe i njeti ka pësuar lëndim trupor, mirëpo i padituri ka pretenduar se lëndimi të cilin e ka pësuar paditësi ka qenë lëndim i lehtë trupor (për të cilin edhe është shpallur fajtor me aktgjykimin penal), dhe për këtë lëndim nuk i takon shpërblimi i dëmit.

Me nenin 154 al.1 të Ligjit mbi Marëdhëniet e Detyrimeve (LMD), është paraparë se ***“kush i shkakton tjetrit dëmin, ka për detyrë ta kompensoj, në qoftëse nuk provon se dëmi ka lindur pa fajin e tij”***. Sipas nenit 14 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), është paraparë se ***“në procedurën kontestimore gjykata më pikpamje të ekzistimit të veprës penale dhe të përgjegjësisë penale të kryerësit, është e lidhur me aktgjykimin e formës së prerë të gjykatës penale, me të cilin i pandehuri është shpallur fajtor”***.

Gjykata për të vërtetuar lartësinë e kërkesëpadisë së paditësit për dëmin jo material të kërkuar, sipas propozimit të palës, ka bërë nxjerrjen e provës me ekspertizën e ekspertit mjekësor Dr. Xh. S., ortoped-traumatolog, i cili në mendimin e dhënë me shkrim ka konstatuar se pas shikimit të gjithë dokumentacionit mjekësor në shkresat e lëndës dhe ekzaminimit të drejtëpërdrejtë që i ka bërë paditësi ka konstatuar se paditësi në rastin e lëndimit paditësi B. Rr. ka pësuar: lëndim të rëndë trupor për shkak të qarjes së indeve të buta dhe muskujve të këtij regjioni dhe ndalimit të kësaj copëze metalike me dimensione prej 12 me 6 ml, në të ngritura kockore të anës së majtë të mjekrës, pasi që ka pësuar plagë nga arma e zjarrit në regjionin e anës së majtë të mjekrës, ku aktualisht ekziston trupi i huaj metalik. Në momentin e lëndimeve trupore, paditësi ka përjetuar dhimbje fizike si në vijim: a) me intensitet posaçërisht të rëndë- 30 minuta; b) me intensitet të rëndë- 12 orë; c) me intensitet të mesëm-10 ditë; dhe d) me intensitet të ulët-ka vazhdimisht edhe në ditët e sotme e që më të shprehura janë gjatë nbrëmjes dhe varësisht nga ndryshimet klimatike. Dëmtimet e lartcekura nuk kanë ndikuar në zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetësor. Shëmtimi ekziston në shkallë të lehtë për shkak të vrazjës me gjatësi prej 0,5x0,5 cm, e cila është shkakuar nga copëza metalike e armës së zjarrit.

Gjykata pas vlerësimit të provave të administruara e sidomos mendimit dhe konstatimit të ekspertit mjekësor Dr. Xh. S. ortoped-traumatolog, e të cilit mendim

gjkata në tërësi ia fali besimin, pasi që mendimi ishte dhënë në mënyrë profesionale dhe objektive dhe gjeti se kërkesëpadija e paditësit B. Rr. është e bazuar ashtu siç është aprovuar në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, pasi që lartësia e aprovuar në emër të gjitha llojeve të dëmit jo material është adekuate me lëndimet e pësuar të paditësit.

Në bazë të lartcekurave gjykata ka vërtetuar se i padituri është përgjegjës ndaj këtu paditësit konform përgjegjësisë në bazë të fajsisë, të parashikuar me dispozitat e lartcekura të nenit 158 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD) dhe dispozitave mbi kompensimin e dëmit konform shkallës së përgjegjësisë së tyre për dëmin jo material të shkaktuar, e të parapara me dispozitat nenit 200 të LMD-së, e lidhur me nenin 323 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK). Në lidhje me kërkesat e aprovuara në shumat si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, gjykata është e mendimit se të njëjtat janë adekuate, e krejt kjo duke marr parasysh dëmin që i është shkaktuar paditësit dhe se lartësia e shumës së të hollave në emër të kompensimit, do ti mundësoj të dëmtuarit – këtu paditësit satisfaksion që ai të jetë në gjendje që deri në një masë, t'i kompenzoj të mirat jomateriale nga të cilat është privuar, respektivisht atë shkallë të satisfaksionit të cilën ai do ta kishte poqëse të njëjtat nuk do t'i kishte humbur, e krejt kjo duke pasur parasysh të gjitha rrethanat e lëndimeve të shkaktuara, intenzitetin e dhimbjeve dhe kohëzgjatjen e tyre dhe kohën e nevojshme të shërimit, respektivisht pasojat e lëndimeve më afër të përshkruara si në mendimin e ekspertit të lartcekur. Po ashtu, gjykata me rastin e vendosjes për kërkesën mbi kompensimin e dëmit jomaterial, si dhe në lidhje me shumën kompensimit të këtij dëmi, mes tjerash gjykata ka pasur parasysh rëndësinë e shkeljes së të mirës dhe të qëllimit të cili i shërben ky kompensim, e gjithashtu edhe faktin se me të njëjtin të mos u shkoj përshtat synimeve që nuk janë të pajtueshme me natyrën e këtij kompensimi dhe qëllimin e tij shoqëror.

Përfundimisht, Gjykata konsideron se lartësia e aprovuar në emër të kompensimit të dëmit jo material është shpërblim real dhe objektiv e që e njëjta paraqet një formë të satisfaksionit që paditësi me këto mjete të plotëson nevojat dhe të mirat materiale që përndryshe nuk paraqesin kompensim absolut të dëmit.

Ndërsa sa i përket pjesës refuzuese, respektivisht shumës mbi shumat e aprovuara, gjykata të njëjtat i refuzoi si të pa bazuara. Mbi bazën e të lartcekurave, gjykata vlerëson se shumat e kërkuara me kërkesëpadija përtej shumave të aprovuara, nuk janë reale dhe se të njëjtat nuk i përgjigjen shkallës së përgjegjësisë deliktore civile të të paditurit për rastin e lëndimit në fjalë.

Gjykata nuk i mori për bazë pretendimet e të autorizuarit të të paditurit se paditësi në këtë aksident ka pësuar lëndime trupore për të cilat nuk i takon shpërblimi, pasi që për këtë edhe është shpallur fajtor në procedurën penale dhe gjykata është e lidhur në shpërblimin e dëmit me këtë vendim, pasi që me mendimin dhe konstatimin e ekspertit mjekësor Dr. Xh. S. ortoped-traumatolog të dhënë në këtë procedurë është konstatuar se paditësi në këtë rast ka pësuar lëndime të rënda trupore (të cilin mendim e ka arsyetuar në mënyrë profesionale) dhe se gjykata civile është e lidhur me aktgjykimin e dhënë në procedurë penale vetëm sa i përket fajësisë të paditurit.

Për detyrimin e të paditurit për të paguar kumatën vjetore, gjykata vendosi konform nenit 186 dhe 277 par.1 të LMD-së, pasi që i padituri është vonuar në pagesën e detyrimit ndaj paditësit dhe ka pranuar si moment të llogaritjes së kumatës datën e nxjerrjes së këtij aktgjykimi.

Gjykata ka vlerësuar edhe theksimet e tjera të palëve ndërgjyqëse, por ka gjetur se të njëjtat janë pa ndikim në nxjerrjen e këtij aktgjykimi.

Nga të lartcekurat u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, e konform nenit 143 të LPK-së.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale është nxjerrur konform nenit 449 dhe 452.2 të LPK-së dhe tarifës zyrtare për përfaqësime dhe atë si në vijim: për një përfaqësim 135.20, si dhe shpenzimet e ekspertizës në shumë prej 150 euro, respektivisht shumën e tërësishme të shpenzimeve prej 285.20 euro, pasi që këto janë shpenzime proporcionale me suksesin e arritur në procesin gjyqësor, ndërsa pjesën tjetër të shpenzimeve të kërkuara e refuzoi si të pabazuara.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
C.nr.945/09, datë 19.06.2014

Sekretarja juridike
Majlinda Shala

Gjyqtari
Arsim Hamzaj

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 dite pas ditës së pranimit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet kësaj gjykate.